REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 310/19
Datë/Datum. 21.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Komuna Junik** OE ankues **"Andident"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP **Nr.310/19**
Prej:	Ekspert shqyrtues i prokurimit **Muhamet Kurtishaj**		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me **Nr.310/19** të parashtruar nga OE **"Andident"**- Ferizaj lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve mjeksore" me nr. prokurimi 636-19-3407-236**		
Datë	21.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e **dt:13.06.2019** me **nr.310/19** të parashtruar nga OE **"Andident"**- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve mjeksore" me nr. prokurimi 636-19-3407-236**, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Komuna Junik.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

		14.06.2019	**21.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 13.06.2019 OE **"Andident"- Ferizaj**, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "Buli-Medical"** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve mjeksore" me nr. prokurimi 636-19-3407-236** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Junik**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues **"Andident"- Ferizaj**

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues janë:

- Neni 6 i LPP-së (Ekonomiciteti dhe efikasiteti)
- Neni 7 i LPP-së (Barazia në trjatim-Jo/diskriminimi)
- Neni 51 i LPP-së (Njoftimi i kritereve te përzedhjes)
- Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 60 i LPP-së (Kriteret për dhënien e kontratave)
- Neni 72 i LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë)
- Neni 108/A i LPP-së (Zgjidhja preliminare e mosmarrveshjeve)
- Neni 43 – Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Ne OE ANDIDENT kemi qene oferuesi me cmim me te lire, kurse AK ka rekomanduar per kontrat OE ne kundershtim me paragrafi 1 te Neni 6.

Neni 7 Barazia ne Traitim/Jo-Diskriminimi

Ne OE ANDIDENT jemi trajtuar jo i barabarte me kompanin tjeter te rekomanduar per kontrate dhe ne menyre diskriminuese jemi eliminuar dhe per faktin se kemi gene ofertuesi me cmim me te lire dhe ne harmoni me kriteret e tenderit, kurse AK ka rekomanuar per kontrate kompanin me cmim me te lute.

Gjate vlesimit te keti tenderi AK ka bere shkelje të LPP Neni 7 Paragrafi 1 sepse ne si nuk jemi trajtuar si operatori ekonomik ne menyre te barabarte dhe ne si OE jemi diskriminuese nga AK Komuna Junikut per here dyte po ne te njejtin aktivtet te prokurimit edhe pse dy here kemi qene me cmim me te lire edhe kemi plotesuar kriter ne DT.

43. Njoftimi i Tenderuesve / Kandidateve

Sipas LPP dhe RRUOPP AK ka qene i obliguar qe tenderuesit pra OE te informoj permes publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK, ne platformen elektronike dhe si vendimin mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit dhe Letrat Standarde perkatese per Tenderuesit me arsytimet e nevojshme siq eshte parapare pike 43 te RRUOPP, por AK ka bere publike vetem Njoftimi mbi Vendimin e AK i publikuar ne e-prokurim me data 05.06.2019 por ky Njoftim mbi Vendimin e AK nuk eshte ne perputhje me LPP dhe RRUOPP pika 43.Njoftimi mbi Vendimi nga AK eshte publikuar (pa vule dhe pa neshkrim shikon Proven 3) kurse Letrat Standarde perkatese nuk jane publikuar fare ju lutem shikon ne eprokurim gjithashtu nuk kemi pranuar as ne posten elektronik nje te tille (shikoni Proven 1 dhe Proven 2 te bashkangjitur ne fund te Ankeses)
Duke pasur parasysh se AK nuk ka bere publikimin e Letres Stadarete per Tenderues te eliminuar, te sukseshem apo te pasukseshem pra duke mos publikuar Letren Stadarete per Tenderues te eliminuar ne nuk kemi pasur informacion pse jemi eliminuar dhe per kete AK na ka mohuar te drejten themelore te pergatitjes e nje Ankeses per rishqyrtim te plote tek AK dhe per te kundershtuar pretendimet e AK se ne nuk kemi plotesur kriter e DT.

Neni 51 Nioftimi i Kritereve te Perzgledhies

AK nuk ka respektuar Neni 51 paragrafi 1 sepse nuk ka perzgjedhjen e OE duke u bazaur ne kriter e cekura ne Njoftimin e kontratees dhe DT.

Neni 59 Elizaminimi, Vlereshni dhe krahasimi i Tendereve

Neni 59 nuk eshte respektuar nga AK, OE i rekomanuduar per kontrate ka ofertuar me cmim me te larte ne krahasim me oferte tone pra te OE ANDIDENT, ku rekomandimi i AK per kontrate eshte OE BULI-MEDICAL qe bie ndesh gjithashtu edhe me Neni 60 paragrafi 1 alinen 1.1 dhe me DT. Ne besoj se AK duhet te konsideroje nje tender si te pergjegjshem vetem ne baze Neni 59 sidomos paragrafi 2 dhe 4 por AK ka bere shkelje te ketyre Neneve sepse oferten tone nuk e ka vlersuar ne baze kritereve dhe kerkesave te parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit, sepse vetem kerkesat dhe kritere e dhenies se kontrates te specifikuara ne njoftim per kontrate dhe dosje te tenderit mund te perdoren si baze per vleresim por AK kete e ka shperfillur gjate vlersimit te ofertes tone.

Ne baze te Njoftim mbi Vendimit e AK ku ne nuk jemi shpallur fitues dhe duke mos publikuar apo pranuar Letren Stadarete per Tenderues te eliminuar nga AK, ne kemi paraqitur Ankes per rishqyrtim te AK, dhe ne kemi pranuar shkresen pra Njoftim pra jo Vendim per refuzim te Ankeses sone siq e parashe LPP Neni 108/A dhe citim i Njoftimit te AK eshte citim "komisioni i vleresimit ka konstatuar se ne kriteret teknike dhe profesionale deshmia e kerkuar per servisimin e aparatit MEDONIC M-SERVIS tek kompania juaj nuk egziston" nese ka qene ky arsytim pse nuk ka bere kete ne Letren Standarte per tenderues te eliminuar por edhe ky kriteri qe supozon AK nuk ka qene ne Njoftimin per kontrate dhe DT siq pretendon AK, por AK ne DT ka cekur kete kriteri te Kapaciteti teknik dhe profesionale si kriter ka qene "Kerkesa 1 Certifikate e servereve (gabim drejt shkrimor nga AK pra servereve = serviser) dhe duke u bazur ne Neni 59 te LPP, AK duhet te bene vlersimin vete ne baze Njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit dhe ne kete rast pretendimet e AK nuk jane reale dhe nuk qendrojn, ne kemi dorzuar ne oferten tone ne kete aktivitet te prokurimi ne platformen e e-prokurim pra ka qene e bashkangjitur ne oferten tone te gjitha kerkesat te cekura ne Nioftimin e kontrates dhe DT, ku edhe ky kriter ka qene plotesuar "Kerkesa 1 Certifikate e

servereve" per me shume shikon kete DT ne platofroma e-prokurim dokumentin e bashkangjitur apo fajlin e emertuar "4 Kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale Kerkesa 1 Certifikate e serviserit" Proven 4 ose ne e-prokurim kete aktivitet te prokurimit dhe serviseri jone eshte i licencuar nga Kompani BOULE per servisimi e pajisjeve labaratorit té kompanise BOULE por AK nuk ka pasur informacion se kompania ne fjalë pra kompani BOULE prodhon edhe aparatin Medonic edhe per kete kemi te bashkangjitur Proven 4 dhe 5 siq verehet kompani BOULE ne dyja eshte pergjegjese ju lutem shikon provat e bashkangjitura, gjthashtu AK duke te kete parasysh se tani nuk ka baze ligjore qe paraqes kritere shtes dhe pengesa te panevojshme ku si qellim kryesor ka eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit.

Neni 60 Kriteret per Dhenien e Kontrates

Gjate keti aktiviteti te prokurimit nuk e keni respektuar Neni 60 Paragrafi 1 dhe alinen 1.1 Sepse kriter per dhenje te kontrates publike ka qene alineja 1.1 e pargrafit 1 pra alineja 1.1 citim "tenderin e pergjegjshem me cmimin me te ulet" ne si OE kemi ofertuar me çnimin me te ulet dhe kemi plotesuar kriteret ne dosjen e tenderit dhe kemi qene OE i pergjegjshem, kurse AK nuk na ka dhene asnje informacion pse jemi eliminuar, duke mos na informuar me email apo publikuar ne e-prokurim Letrat Standarde perkatese, ky aktivitet i prokurimit bie ndesh me LPP.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese

Nuk eshte respektuar Neni 72 pasi qe nuk eshte kerkuar asnje sqarim shtese nga OE ANDIDENT, por ne si kompani dhe oferta jone si me e lire eshte anashkaluar dhe ne jemi eliminuar nga AK pa kerkuar informacion shtese dhe sqarim shtese siq e parashe ky nene. Nese per ndonje arsyje teknike, adminstrative apo paqartesi tjera AK nuk e ka mundur te shkarkoj nga platofroma e-prokurim dokumentin e bashkangjitur apo fajlin e emertuar "4 Kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale Kerksa 1 Certifikate e servereve (serviserit korrigjuar nga ne) " apo ka pasur nevoj per sqarim nga OE `ANDIDENT" ka mundur te kerkoj informacion shtese sipas LPP Neni 72 e kjo duke na eliminiuar pa te drejt dhe pa zbatuar Neni 72 te LPP.

Neni 108/A Zdidhja preliminare e mosmarreveshieve

Ankesa per rishqyrtim te AK eshte dorzuar ne perputhje me LPP Neni 108/A por AK nuk rishqyrtuar Ankesen tone ne perputhje me Neni 108/A sepse AK nuk respektuar Neni 108/A pagragrafi 10 citim" 10. Autoriteti kontraktues mund, me ane te nje vendimi' te refuzoj nje Ankese kurse AK Ankese tone ju ka pergjigjur me Leter Njoftimi (shikoni Njoftimi e bashkangjiture ne Ankes ose e-prokurim te moduli Kerkesat per rishqyrtim shikon cfare pergjiglie kemi pranar nga AK per Ankesen tone e cila esht e pa vule, pa neshkrim) edhe nuk ka asnje element te nje Vendimi te AK, pra ky Njoftim nuk ka asnje kriter dhe element te nje Vendimi sepse ky Njoftim ka nje anomali citim nga Njoftimi" Bazuar ne kerkesen e dates, 10.06.2019, per sqarimin e pozicionit.6.5.te paramases se projektit" ne kemi dorzuar Ankes te AK me dt.07.06.2019 ky Njoftim nuk eshte Vendim per Ankesa tone, nuk permbane si shprehjet elemente te Vendimit, nje Vendimi duhet te bazohet Ligje dhe ne Nene perkatese etj, pra ky Njoftim nuk i permbush aspektin ligjor sepse Vendim duhet te informoj ankuesin me te drejta ligjore, keshilla ligjore te cilat i takojn tutje Ankuesit.

Ne kerkojm qe te detyrohet dhe obligohet AK te veproj ne perputhje LPP dhe ky aktivitet i prokurimit te rikthehet ne **ri-vlersim** dhe gjate vlersimit te keti tenderi AK te respektoj LPP ne pergjithesi dhe keto Nene ne veqanti si Nenet 6,7,59,60, 72,108A dhe RRUOPP Pike 43 ka krijuar dyshime se ky proces ka pasur leshime te medha dhe shkelje te LPP.

Ligjerisht ky aktivitet i prokurimit eshte ne kundershtim me LPP, per shkak se pershtatshmeria vlersohet pas publikimit te dokumenteve qe jane te detyrushme me dosje te tenderit.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	23.05.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Kontratë publike kuotim, shërbime
Vlera e parashikuar e kontratës:	2,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	29.05.2019
Data e hapjes së ofertave	29.05.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave	05.06.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të **eliminuar** apo të pa suksesshëm	05.06.2019
Data e njoftimit për dhënien e kontratës:	05.06.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	08.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim	10.06.2019

Kriteret për vlerësim:
Çmimi më i lirë

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

1. Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi përshtatshmërinë të ligjit të prokurimit , Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.(Obligative për të gjithë OE)
2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se OE i ka kryer obligimet tatimore deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.
3. Vërtetim nga Gjykata Ekonomike - që nuk është në procedurë gjygjësore ose i dënuar më parë për vepër penale, vërtetimi jo më i vjetër se tre muaj përpara dorëzimit të tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit , duke përdorur formën në Ankesin 2.
2. Vërtetim nga ATK-ja se nuk është në vonesë jo me i vjetër se 3 muaj nga data e shpalljes së tenderit
3. Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike. (Origjinal)

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit,regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.
2. Certifikatë e numrit fiskal
3. Certifikatë e TVSh-së

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1. Te dëshmohet me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-kopj.
Evidenca 2.Te dëshmohet me Certifikatë te Numrit Fiskal- Kopje.
Evidenca 3.Te dëshmohet me Certifikatë te TVSh-së – Kopje

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1. Certifikate e serverëve.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1.Qertifikata e servisereve të autorizuara nga prodhuesi për mirmbajtjen e ktyre paisjeve.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	"Buli-Medical" SHPK	Prishtinë	1.890,00€	JO
2.	"Andident"	Ferizaj	1.800,00 €	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për rivlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Ali Kuqi– Kryetar i komisionit
- Avdyl Maloku–Anëtar i komisionit
- Shefqet Hulaj– Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Autoriteti kontraktues ka rekomanduar per kontrate:

- Operatorin ekonomik **"Buli-Medical"** me vleren e ofertes **1.890,00€.**

Deklarate:

Komisioni i vleresimit konstaton qe N.T.P "Buli-Medical" i ploteson te gjitha kerkesat e kerkuara.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Andident"- Ferizaj

Përgjigje nëPretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka shkelur nenin 6 dhe 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve ka rekomanduar per kontrate OE ekonomik ne kundërshtim me paragrafin 1 te nenit 6 te LPP-se dhe po ashtu ne jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar si OE ne menyre te barabarte me ç'rast komuna e Junikut ka bere shkelje te paragrafit 1 te nenit 7 te LPP-se, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kritereve të dhëna në DT dhe në këtë rast ka bërë eliminimin e ofertës së OE ankues me arsyetimin se nuk e ka përmbushur një kërkesë të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontrtaë.

Në rastin kur oferta vlerësohet e pa përgjegjëshme dhe e njëjta eliminohet si e tillë, atëherë nuk kemi shkelje të nenit 6. Shkelja do të ishte nëse ofera është vlerësuar si e përgjegjëshme dhe të njëjtës nuk i jepet kontrata. Po ashtu kur oferta e OE ankues është vlerësuar e pa përgjegjëshme dhe ajo e rekomanduara për kontratë e përgjegjëshme, atëherë nuk kemi shkelje edhe të nenit 7. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2.

Lidhur me tjetërin pretendim të OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit51 paragrafi 1 të LPP-së sepse nuk ka përzgjedhë operatorin ekonomik duke u bazuar në kriteret e caktuara në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit edhe në njoftimin për kotnratë janë paraparë kriteret e përzgjdhjes sipas nenit 51 të LPP-së. Përzgjedhja e operatorëve ekonomik gjatë vlerësimit të ofertave është bërë në përputhje me këto kritere.

OE ankues është eliminuar si i pa përgjegjshëm për shkak të mos plotësimi të një kriteri të përzgjedhjes të dhënë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Nga kjo shihet se nuk ka pasur shkelje të nenit 51

të LPP-së. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **pa bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur pretendimin vijues të OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së sepse OE i rekomanduar për kontrtaë ka ofertuar me çmim më të lartë se oferta e jonë dhe AK duhet të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm në bazë të nenit 59 sidomos paragrafit 2 dhe 4, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

E theksuam edhe më lartë që eleminimi i OE ankues është bërë për shkak të mos plotësimit të një kërkese të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Kjo kërkesë ka qenë:

- *Çertifikata e serviserit*, ndërsa Evidenca *"1 Çertifikatë e serviserëve të autorizuar nga prodhuesi për mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve laboratorike"*

OE ekonomik ankues nuk ka ofruar me dokumentet e dorzuara në platformën elektronike çertifikatë të serviserit të autorizuar nga prodhuesi për mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike siç është kërkuar. Mirëpo ka ofruar një shkrse se punëtori Kadri Ilazi ka ndjekur një trajnim kompanisë "Bolue" për shërbime të hematologjisë.

Ky dokument nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit sepse nuk është çertifikatë e serviserit të autorizuar prej prodhuesit. Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi se serviseri është i certifikuar nga kompania "Bolue". Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë me ofertën e tijë ka dorzuar edhe Autorizimin që ka prej prodhuesit "Boule". Pra me këto dokumente OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kërkesën e dosje së tenderit dhe nga kjo rezulton se autoriteti kontraktues ka respektuar nenin 59 të LPP-së. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **pa bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin tjetër, se AK nuk ka respektuar nenin 60 dhe 72 të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontratë OE me çmim më të lartë dhe nuk ka kërkuar sqarime shtesë për dokumentet e dorëzuar nga OE ankues, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Është rekomanduar për kontratë OE i vetëm që ka dorëzuar ofertën e përgjegjëshme, ndërsa OE ankues ka qenë i pa përgjegjëshme sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e DT dhe njoftimit për kontratë që e përmendëm më lartë. Nuk ka pasur shkeljet të nenit 60 të LPP-së në këtë rast. Po ashtu AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë në bazë të nenit 72 sepse nuk ka pasur pa qartësi rreth dokumentit të ofruar nga OE ankues. Neni 72 shumë qartë e precizon se AK **mundet** të kërkoj sqarime shtesë kur ai e sheh të nevojshëm, mirëpo nuk është detyruese për AK të kërkoj sqarime shtesë kur nuk ka pa qartësi. Prandaj nuk ka shkelje të nenit 72 të LPP-së dhe si i tillë edhe ky pretendim ankimor është i **pa bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor të OE për shkelje të nenit 108/A të LPP-së nga ana e autoritetit kontraktues sepse në përgjigjëje të kërkesës për Rishqyrtim AK nuk ka lëshuar vendim por vetëm një njoftim për OE ankues se i refuzohet kërkesa pëe rishqyrtim, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Si rregullë në nenin 108/A të LPP-së parashihet që AK duhet të nxjerrë vendim si përgjigjëje në kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues. Në këtë rast AK nuk e ka bërë këtë vendim por ka dhënë vetëm njoftim me shkrim. Pra OE ankues ka të drejtë. Mirëpo ky veprim i AK nuk dëmton procesin e prokurimit dhe as OE ankues sepse përgjigjëja është refuzuese për OE ankues. Pra edhe po të ishte vendim e njëjta situatë do të ishte. Tjeshtë është një lëshim procedural i AK pa asnjë ndikim në proces. Me rëndësi është që OE ankues e ka marrë përgjigjëjen e autoritetit kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim dhe OE ankues ka realizuar të drejtën për akesë në OSHP. Ky pretendim ankimor vlerësohet **pjesërisht i bazuar.**

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Gjatë shqyrtimit të kësaj lënde vërehet qartë se autoriteti kontraktues në përgjithësi ka respektuar nenin 59 të LPP-së gjatë procesi të vlerësimi, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave. Në këtë proces ka pasur disa dobësi procedurale të AK të cilat nuk kanë ndikuar në procesin e prokurimit. Ato dobësi kanë qenë si, mos njoftimi i OE ankues për arsyet e eleminimit përmes formularit të rregullt standarte të KRPP-së dhe me rastin e përgjigjëjes në kërkesën për rishqyrtim, që nuk është nxjerrë vendim por i është bërë vetëm njoftimi me shkrim i OE ankues. Të gjitha këto devijime të vogëla të AK-së të cilat lejohen edhe me nenin 59 të LPP-së pika 4, nuk kanë ndikuar në vendimin final të AK për të nxjerrë një vendim meritor për dhënie të kontratës. OE ankues është eleminuar me te drejtë si tenderues i pa përgjegjëshme sepse nuk e ka plotësuar një kërkesë të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Në bazë të sqarimet e dhënë më lartë lidhur me përgjigjëjet në pretendimet ankimore të OE ankues, eksperti shqyrtues e vlerëson në përgjithësi akesën si të **pa bazuar** dhe i rekomandon panelit shqyrtues ta **Refuzoj** atë.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të **vazhdoj** me dhënien e kontratës për aktivitein e prokurimit **"Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve mjeksore" me nr. prokurimi 636-19-3407-236** në përputhje me dispozitat e LPP-së.